

Kancelar

MA Alma Sulstarova Laci

Lindur në Tiranë, diplomuar në “Gjuhë Angleze” në Universitetin e Tiranës në vitin 1982. Në vitin 2002 ka ndjekur studime pasuniversitare në Universitetin East Anglia, Norwich, Britani e Madhe. Studimet në Angli u fokusuan në “Menaxhim Projektsh Zhvillimi në Sektorin Social”. Në vitet 2002- 2004 ka përfunduar ciklin e plotë të studimeve pas universitare (2 vjet) në Fakultetin e Shkencave Sociale në UT dhe mban gradën “Master i Shkencave Sociale”.

Ka një experience pune mbi 30 vjeçare e cila mund të ndahet në disa etapa. Etapa e parë i dedikohet arsimit e më pas për shume vite u angazhua në administratën publike, kryesisht në sektorin e marrëdhënieve ndërkombëtare në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Nga viti 2000 deri në 2010 ka menaxhuar disa projekte zhvillimi të financuara nga agjenci të mëdha ndërkombëtare si Banka Botërore, PNUD, USAID, CRS, SDC / Swisscontact, etj. Projektet e zhvillimit kanë pasur në focus zhvillimin dhe reformimin e sektorit social dhe arsimit profesional. Nga viti 1996 e në vazhdim ka punuar si konsulentet locale për vlerësimin e projekteve të financuara nga agjenci ndërkombëtare e të zbatuar nga NGO shqiptare e rajonale (kontraktuar nga PNUD, ETF, SIDA, UNICEF, UNESCO, Ambasada Holandeze, British Council, etj). Për shkak të angazhimeve të saj ka një ekspozim të konsiderueshëm në agjencitë kombëtare e ndërkombëtare të fokusuara në sektorin social dhe arsimin profesional si dhe në komunitetin e shoqërisë civile në nivel kombëtar e rajonal. Nga Janari i vitit 2011 e në vazhdim punon në Universitetin POLIS si Kancelare e këtij universiteti.

